



Data: 29/07/2019

Ref.: 1364/19/P

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

#### V E N D I M

I. Nuk akreditohen programet e studimit në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”:

- Mjekësi Familjare dhe Kujdes Paliativ, MSc, 120 ECTS
- Shkenca e Mësimdhënies në Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe, MSc, 120 ECTS

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### Arsyetimi

I. Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitivin të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani” më datë 07.05.2019 me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Danica Zeleznik dhe Prof. Dr. Dhurata Shehri.

Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sa i përket programit të studimit Mjekësi Familjare dhe Kujdes Paliativ, MSc, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit, kanë konstatuar se ky program i studimit plotëson pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Sipas tyre, mangësitë kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim janë kurrikula e programit e cila sipas eksperteve është kontradiktore. Kjo për faktin se Universiteti i Gjakovës në misionin e paraqitur për këtë program ka për qëllim që përmes këtij programi të edukoj studentët, pra program edukativ dhe arsimor, ndërsa që emri dhe kurrikula e programit reflektojnë një program që për qëllim ka krijimin e kuadrove të fushave të tjera mjekësore. Për më tepër, ekspertët ndërkombëtar rekomandojnë që emërtimi i programit të ndërrohet nga Mjekësi Familjare dhe Kujdes Paliativ MSc në Shkenca Mjekësore dhe Kujdes Paliativ MSc. Gjithashtu ekipi i ekspertëve rekomandon një analizë rreth shpërndarjes së orëve dhe ECTS-ve, sipas rekomandimeve të dhëna në raport.

Sa i përket programit të studimit Shkenca e Mësimdhënies në Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe, MSc, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit, kanë konstatuar se ky program i studimit plotëson pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Ekspertët kanë gjetur se programi nuk ka të definuar qartë konceptin e hulumtimit dhe se hulumtimi nuk është i përfshirë në të gjitha aktivitetet relevante. Pos kësaj është konstatuar se te pjesa më e madhe e stafit nuk ka dëshmi të ndjekjes së trajnimeve për avancim të metodave të mësimdhënies si dhe është vërejtur pjesëmarrje e vogël e tyre në projekte ndërkombëtare. Gjithashtu ekspertët kanë theksuar mungesën e një librarie të pajisur mirë dhe të sallave të leximit. Programi si i tillë ka mbivendosje të përmbajtjes në lëndë të ndryshme dhe se i mungon komponenti i praktikës. Si përfundim ekipi i ekspertëve ka konstatuar se programi në fjalë nuk siguron arritjen e shkathtësive dhe kompetencave të studentëve që janë të nevojshme për një program shkencor i cili shpie në nivelin PhD. Prandaj nga sa u tha më lartë, ekspertët rekomandojnë që programi të rishikohet dhe të shndërrohet nga master shkencor në master profesional.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë